



Referencat ndaj certifikimit të dhënë nga European Quality and Safety Control (EQSC) Sh.p.k



Rr. Sulejman Pasha, Pallati 70/1, Kati 1,
Nr.1; 1016 Tiranë
Cel: +35569 60 87 402
www.eqsc-cert.org
info@eqsc-cert.org

Ky dokument përcakton rregullat, të drejtat dhe detyrimet e klientëve të certifikuar nga European Quality and Safety Control (EQSC) Sh.p.k në lidhje me përdorimin korrekt të referencave ndaj certifikimit, përfshirë përdorimin e logos së EQSC, referencave tekstuale dhe çdo elementi tjetër identifikues të certifikimit të dhënë.



1. Referencat ndaj certifikimit të EQSC

Klientët e certifikuar nga European Quality and Safety Control (EQSC) Sh.p.k mund të përdorin referencat ndaj certifikimit të dhënë nga EQSC (si p.sh. tekstin, logon, etj.), vetëm për ato aktivitete dhe fushëveprim për të cilat janë certifikuar. Nuk lejohet përdorimi i referencave në mënyrë që të krijohet përshtypja se i gjithë aktiviteti i kompanisë është i certifikuar nga EQSC, nëse një gjë e tillë nuk është e saktë.

1.1. E drejta e përdorimit

Referencat e certifikimit, siç përcaktohen në këtë procedurë, mund të përdoren vetëm nga Klientët e certifikuar (certifikimi i të cilëve vazhdon të jetë aktiv) si dhe të cilët kanë rënë dakord paraprakisht me FP.310_9 Termat dhe kushtet e ofrimit të shërbimit.

Referencat e certifikimit dhënë nga EQSC nuk do të përdoren në produkt apo në paketimin e produktit, të dukshëm për konsumatorin ose në çfarëdo mënyre tjetër, që mund të interpretohet si paraqitje e konformitetit të produktit. EQSC nuk lejon markat e tij të përdoren në raporte laboratorike, certifikata kalibrimi apo inspektimi, sepse të tilla raporte konsiderohen si produkte në kontekstin e kësaj procedure.

Klientët e certifikuar do të përdorin referencat ndaj certifikimit siç përcaktohen nga EQSC, në:

- Materiale promocionale (broshura, fletëpalosje, etj.);
- Panairë, takime, etj.
- Në automjete apo struktura të përhershme (siç janë ndërtesat),
- si dhe në çdo vend tjetër që konsiderohet i përshtatshëm për një përdorim të tillë.

Për aq sa një përdorim i tillë ka të bëjë me aktivitete, të tilla si zhvillimin, prodhimin, shpërndarjen e produkteve/shërbimeve për të cilat certifikimi i sistemit është dhënë.

Kur klienti ka më shumë se një filial, atëherë referencat ndaj certifikimit mund të përdoren vetëm nga filialet që janë të certikuara.

1.2. Referenca ndaj certifikimit në formë të shkruar

Referenca në formë të shkruar ndaj certifikimit të dhënë nga EQSC duhet të përmbajë njërin nga formulimet e mëposhtme:


- **“Sistem i Certifikuar Menaxhimi” nga EQSC, Shqipëri, ose**
- **Kompania xxx përdor Sistem Menaxhimi të certifikuar EQSC (ISO xxx/HACCP, etj.) për prodhimin/përpunimin e xxxx [produkt/shërbim].**

Në të gjitha rastet kur përdoret njëra nga shprehjet e mësipërme, duhet të përfshihet edhe numri unik i certifikatës në këtë formë: **Nr. 00XX**.

Shembull paraqitje mund të jenë:



Shembull 2 Kur përdoret bashkë me Logon e EQSC



Shembull 1 Kur nuk përdoret së bashku me logon e EQSC

Përdorimi i logos së EQSC në Shembullin 1, jepet vetëm në rastet kur Menaxhim i lartë i EQSC, gjykon që nuk ka mundësi për keqpërdorimin e saj.

Lloji i shkrimit, madhësia dhe ngjyra, duhet të jenë të tilla që të vihen re menjëherë, të qarta, dhe i përdorur në vendin e duhur, për të përjashtuar çdo përdorim që mund të çojë në keqkuptim apo keqinterpretim të certifikimit të dhënë.



1.3. Referenca në formë vizive (markë)

Aktualisht, EQSC nuk ka përcaktuar një markë specifike që mund të përdoret nga klientët e certifikuar si referencë vizive ndaj certifikimit.

2. Certifikata e Konformitetit

Certifikata e lëshuar nga EQSC për të dëshmuar konformitetin e sistemit të menaxhimit të klientit është pronë e EQSC dhe mund të përdoret nga klienti vetëm për sa kohë që certifikimi është aktiv dhe i vlefshëm.

Në rastet kur certifikimi pezullohet, tërhiqet apo anulohet, përdorimi i mëtejshëm i certifikatës është i ndaluar dhe dokumentet përkatëse duhet të kthehen menjëherë te EQSC.

Certifikata origjinale, si dhe kopjet e saj, mund të përdoren për qëllime promovionale (si panairë, takime, etj.) apo në aplikime për tendera, konkurse dhe procese të tjera zyrtare.

Megjithatë, nuk lejohet përdorimi i kopjeve të certifikatës që mund të krijojnë keqkuptime ose të çojnë në keqinterpretim të statusit të certifikimit. Të gjitha kopjet e përdorura nga klienti duhet të jenë të kontrolluara dhe të miratuara nga EQSC, nëpërmjet vendosjes së vulës zyrtare të kompanisë, ose të jenë të noterizuara.

Çdo kopje tjetër që paraqitet si origjinale, pa pasur miratimin përkatës, është e ndaluar për përdorim.

Shkelja e këtyre përcaktimeve mund të çojë në pezullim ose tërheqje të menjëhershme të certifikimit të dhënë nga EQSC.

3. Logo e EQSC

Logoja e kompanisë EQSC është pronë e EQSC dhe përdorimi i saj nga klientët e certifikuar është i lejuar vetëm për qëllime të përcaktuara, në përputhje me kërkesat e këtij dokumenti. Klientët me certifikim të vlefshëm mund ta përdorin logon në materiale promovionale, faqe interneti, broshura apo materiale të tjera, pa pasur nevojë për miratim paraprak me shkrim, për sa kohë respektohen rregullat e mëposhtme.

Çdo klient i interesuar mund të kontaktojë zyrën qendrore të EQSC për sqarime ose këshillime të mëtejshme mbi përdorimin e logos. Administratori i EQSC është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e vazhdueshme të përdorimit të logos dhe referencave ndaj certifikimit të dhënë.

3.1. Rregullat e përdorimit të logos së EQSC

EQSC rregullon përdorimin e logos së tij nga klientët e certifikuar, për elementët e mëposhtëm:

- Madhësia e logos. Madhësia e logos duhet të jetë e përshtatshme me llojin e materialit dhe të sigurojë qartësi dhe lexueshmëri. Klientët rekomandohen të konsultohen me EQSC nëse kanë dyshime mbi përshtatshmërinë.
- Font: Fonti i përdorur në logon është *Segoe UI* dhe nuk duhet të ndryshohet.
- Ngjyra: Logoja duhet të përdoret në ngjyrat origjinale RGB: R-153, G-0, B-51. Nëse materiali kërkon një version njëngjyrësh të logos, ajo mund të përshtatet në bazë të sfondit dhe dizajnit, për sa kohë ruhet lexueshmëria dhe integriteti i logos. Në çdo rast lloji i shkrimit (EQSC) duhet të jetë i njëjtë.
- Vendndodhja në material. Logoja e EQSC duhet të vendoset në një vend të dukshëm, pa konkurruar me logon ose simbolet e vetë klientit. Ajo duhet të jetë qartë e dallueshme dhe të mos krijojë konfuzion në interpretim.



4. Ndalimi i përdorimit të logos së akreditimit

Përdorimi i logos së trupit të akreditimit nga klientët e certifikuar nga EQSC është rreptësisht i ndaluar. Klientët nuk lejohen ta përdorin këtë logo në asnjë material promocional, dokumentacion, faqe interneti, produkte apo komunikim tjetër publik.

Logoja e akreditimit është pronë e trupit të akreditimit dhe mund të përdoret vetëm nga EQSC në përputhje me rregullat dhe kufizimet e përcaktuara në marrëveshjen përkatëse me trupën e akreditimit.

Çdo përdorim i paautorizuar i logos së akreditimit nga klientët konsiderohet shkelje serioze e kushteve të certifikimit dhe mund të çojë në masa disiplinore, përfshirë pezullimin ose tërheqjen e certifikatës.

5. Mbikëqyrja e përdorimit

Mbikëqyrja e përdorimit të referencave ndaj certifikimit dhe logos së EQSC nga klientët e certifikuar do të realizohet nëpërmjet:

- Auditimeve të kryera nga EQSC;
- Informacionit të marrë nga komentet apo ankesat e palëve të interesuara (si konsumatorë, furnitorë, etj.);
- Kontrollit të përmbushjes së detyrimit për miratim paraprak të përdorimit të referencave nga klienti.

Administratori i EQSC është autoriteti përgjegjës për kryerjen e kësaj mbikëqyrjeje, si dhe për ndërmarrjen e masave të nevojshme në rast shkeljesh të përcaktimeve të kësaj procedure.

6. Masat në rast keqpërdorimi

Përgjegjësia për përdorimin korrekt të referencave ndaj certifikimit, logos së EQSC, logos së akreditimit (kur aplikohet) dhe certifikatës së lëshuar nga EQSC, bie plotësisht mbi klientin e certifikuar.

Në rast të keqpërdorimit të tyre, Administratori i EQSC, në bashkëpunim me personelin përkatës, merr masa korrigjuese në përputhje me shkallën e shkeljes. Masat përfshijnë:

Njoftimin me shkrim të klientit për marrjen e masave të menjëhershme korrigjuese, të tilla si:

- Anulimi i të gjithë materialeve të publikuara me referenca të pasakta;
- Tërheqja nga tregu e produkteve që përmbajnë referenca të gabuara ndaj certifikimit apo përdorim të gabuar të logos së EQSC ose të logos së akreditimit (kur aplikohet).

Nëse konstatohet se klienti **nuk ka ndërmarrë masat korrigjuese të kërkuara, EQSC do të pezullojë certifikimin.**

Nëse pas përfundimit të periudhës së pezullimit, klienti nuk ka zbatuar kërkesat e përcaktuara, EQSC do të procedojë me tërheqjen e certifikimit, si dhe do të publikojë në faqen zyrtare listën e përditësuar të klientëve të certifikuar dhe statusin përkatës të certifikimit.

Në rastet kur klienti, pavarësisht tërheqjes së certifikimit, vazhdon të përdorë në mënyrë të paligjshme referencat ndaj certifikimit, logon e EQSC, logon e akreditimit apo certifikatën e lëshuar, EQSC do të ndërmarrë veprime të mëtejshme ligjore, përfshirë:

- Paraqitjen e çështjes për ndjekje gjyqësore pranë Gjykatës së Tiranës;
- Vendosjen e sanksioneve financiare në përputhje me shkallën e shkeljes dhe dëmin e shkaktuar.



7. Keqinterpretimi publik i certifikimit

Klientët e certifikuar nuk duhet të paraqesin certifikimin e dhënë nga EQSC në mënyrë që mund të krijojë përshtypjen se EQSC ka certifikuar produkte, persona, ose shërbime individuale, nëse kjo nuk është objekt i certifikimit të dhënë.

Çdo përdorim i referencave të certifikimit që krijon konfuzion publik ose konsumator për objektin dhe qëllimin e certifikimit do të konsiderohet keqpërdorim dhe do të trajtohet sipas pikës 6 të këtij dokumenti.

8. Ndryshime të statusit të klientit

Klienti është i detyruar të informojë EQSC për çdo ndryshim që mund të ndikojë në përfaqësimin korrekt të certifikimit, si:

- Ndryshimi i emrit të kompanisë,
- Ndryshimi i adresës apo fushës së aktivitetit,
- Ndarja, bashkimi apo shitja e kompanisë.

Përdorimi i referencave ndaj certifikimit pa përditësim të informacionit përbën shkelje të kushteve të certifikimit.

9. Mospërdorimi i certifikimit për promovim mashtrues

Klienti nuk duhet të përdorë referencat ndaj certifikimit të EQSC në mënyra që mund të konsiderohen si reklamim mashtrues, përfshirë:

- Krahasime denigruese me kompani të tjera;
- Pretendime të pasakta për cilësi/siguri absolute ose avantazh të padrejtë;
- Sugjerime që certifikimi përfshin garanci për cilësinë/sigurinë e produktit.